



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

Kom.Dh.Shk.II.nr.1510/2023

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhoma e Shkallës së Dytë, në përbërje nga gjyqtari individual Faton Bajrami, në çështjen përbarimore të kreditorit Daf Sh.P.K., me seli në Ferizaj, rr. “Kadri Zeka”, me autorizim e përfaqëson L.M., avokat nga Ferizaji, kundër debitorit Diagonal Sh.P.K., me seli në Prishtinë, me autorizim e përfaqëson G.V., avokat nga Prishtina, me bazë juridike përbarimore, duke vendosur lidhur me ankesën e debitorit, të ushtruar kundër aktvendimit të Gjykatës Komerciale të Kosovës - Dhomat e Shkalles se Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, KPPP.nr.677/23, të datës 13.06.2023, me datë 05.03.2024, mori këtë:

A K T V E N D I M

REFUZOHET si e pathemeltë ankesa e debitorit Diagonal Sh.P.K., ndërsa aktvendimi i Gjykatës Komerciale të Kosovës - Dhomat e Shkalles se Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, KPPP.nr.677/23, i datës 13.06.2023, **VËRTETOHET**.

A r s y e t i m

Gjykata Komerciale e Kosovës – Dhomat e Shkalles se Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, me aktvendimin e atakuar KPPP.nr.677/23, të datës 13.06.2023, në pikën I të dispozitivit, e ka refuzuar si të pa bazuar prapësimin e debitorit Diagonal Sh.P.K., i ushtruar kundër Urdhrit të Përbaruesit Priva Sheremet Livoreka P.nr.61/2022 të dt. 21.02.2022, me pikën II, ka mbetur në fuqi urdhrin përbarimor të Përbaruesit Privat Sheremet Livoreka P.nr.61/2022 të dt. 21.02.2022 dhe në pikën III detyrohet debitori që në emër të shpenzimeve për përpilimin e përgjigjes në prapësim t’ia paguaj kreditorit shumën prej 78.00 euro, në afat prej 7 ditësh, pas plotfuqishmërisë së këtij aktvendimi.

Kundër këtij aktvendimi, në afatin ligjor ka ushtruar ankesë debitori, për shkak të shkeljeve thelbësore të dispozitave të procedurës, konstatimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe për shkak të aplikimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që gjykata e shkallës së dytë, ta aprovojë si të bazuar ankesën e debitorit, të anulohet aktvendimi i shkallës së parë , shfuqizohet urdhëri përbarimor dhe obligohet kreditori të paguaj shpenzimet përbarimore.

Përgjigje në ankesë nuk ka paraqitur pala kreditori.

Gjykata Komerciale, përmes gjyqtarit individual, i shqyrtoi shkresat e lëndës, aktvendimin e ankimuar dhe pretendimet ankimore, në kuptim të nenit 194 e 208 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), e lidhur me nenin 17 dhe nenin 3 paragrafi 2 të Ligjit nr.04/L-139 për Procedurën Përbarimore (LPP) dhe gjeti se:

Ankesa e debitorit është e pathemeltë.

Nga shkresat e lëndës rrjedh se kreditori Daf Sh.P.K., ka paraqitur propozim për përmbaram, kundër debitorit Diagonal Sh.P.K., në bazë të dokumentit të besueshëm – Faturës Nr. 09-05/2021 të datës 21.05.2021, në emër borxhit për shumën e mjeteve, në lartësi prej 1,305.00 euro, me kamatë ligjore prej 8%, si dhe të gjitha shpenzimet e procedurës përmbaramore.

Përmbaruesi privat Sheremet Livoreka, duke vepruar në bazë të propozimit për përmbaram të kreditorit me urdhrin P.nr.61/2022 të dt. 21.02.2022, ka lejuar përmbaramin e propozuar nga kreditori, ndërsa debitori me datë 03.03.2022, ka ushtruar prapësim duke theksuar se fatura nuk përmbush kushtet ligjore, ngase nuk kuptohet se nga kush është pranuar apo nënshkruar dhe e njëjta nuk përmbanë vulën e debitorit, andaj i propozon gjykatës që të aprovohet prapësimi si i bazuar dhe të shfuqizohet urdhëri përmbaramor.

Përgjigje në prapësim ka ushtruar kreditori, duke theksuar se janë të pa bazuara pretendimet e debitorit në prapësim dhe se e kundërshton kërkesën e debitorit që të mos realizohet përmbarami duke theksuar se debitori nuk e ka dhënë asnjë arsye si ne kuptim të nenit 71 të LPP që të aprovohet prapësimi, andaj edhe ka kërkuar që të refuzoi prapësimin, dhe urdhri përmbaramor të mbetet në fuqi, dhe gjithashtu të paguaj debitori shpenzimet e procedurës.

Gjykata Komerciale e Kosovës – Dhomat e Shkalles së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, duke vendosur lidhur me prapësim e debitorit dhe përgjigjen në prapësim të kreditorit, ka nxjerrë aktvendimin e atakuar KPPP.nr.677/23, i datës 13.06.2023 në pikën I të dispozitivit, e ka refuzuar si të pa bazuar prapësimin e debitorit Diagonal Sh.P.K., i ushtruar kundër Urdhrit të Përmbaruesit Priva Sheremet Livoreka P.nr.61/2022 të dt. 21.02.2022, me pikën II, ka mbetur në fuqi urdhrin përmbaramor të Përmbaruesit Privat Sheremet Livoreka P.nr.61/2022 të dt. 21.02.2022 dhe në pikën III detyrohet debitori që në emër të shpenzimeve për përpilimin e përgjigjes në prapësim t'ia paguaj kreditorit shumën prej 78.00 euro, në afat prej 7 ditësh, pas plotfuqishmërisë së këtij aktvendimi, duke vendosur më decidivishtë si në dispozitivit të të njëjtit.

Në arsyetim të aktvendimit të atakuar gjykata ka theksuar se me shikim në shkresat e lëndës ka gjetur se në rastin konkret kemi të bëjmë me propozim për përmbaram të dokumentit të besueshëm - Faturës Nr. 09-05/2021 të datës 21.05.2021, në emër borxhit për shumën e mjeteve, në lartësi prej 1,305.00 euro, mbi bazë të së cilës përmbaruesi privat e ka lejuar përmbaramin, por ky dokument përbën bazë juridike për caktimin e përmbaramit, ngase i ka plotësuar kushtet ligjore nga neni 29 par 1, 3 dhe 37 të LPP-së, për faktin se ky dokument e ka cilësinë e dokumentit përmbaramor, e po ashtu nga shiqimin në këtë dokument rezulton se përmban të gjitha elementet e kërkuar nga këto nene, të cilat janë përshkruar shërbimet, shumën e detyrimit dhe kohen e përmbushjes dhe fatura është pranuar nga debitori në mënyrë të rregullt. Andaj edhe mbi bazën e këtyre fakteve gjykata e shkallës së parë e ka refuzuar prapësimin e debitorit dhe ka mbet në fuqi urdhrin përmbaramor.

Gjykata Komerciale e Kosovës, Dhomat e Shkalles së Dytë, vlerëson se gjykata e shkallës së parë, në bazë të provave të cilat gjinden në shkresat e lëndës, ka dhënë aktvendim të drejtë dhe të bazuar në dispozita konkrete ligjore, prandaj konkludimin e gjykatës së shkallës së parë, lidhur me këtë çështje e pranon edhe Gjykata Komerciale-Dhoma e Shkallës së Dytë, duke vlerësuar po ashtu se aktvendimi i atakuar është i rregullt dhe i ligjshëm, për arsye se i

njëjti nuk është përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182, paragrafi 1 dhe 2 të LPK-së, dhe se drejtë është vërtetuar gjendja faktike, kështu që mund të hetohet dhe vlerësohet ligjshmëria e tij, shkelje të cilat gjykata e shkallës së dytë i heton sipas detyrës zyrtare në bazë të nenit 194 të LPK-së.

Gjykata Komerciale – Dhoma e Shkallës së Dytë vlerëson se në rastin konkret kemi të bëjmë me propozim për përmbarim, që është në përputhje me dispozitën nga neni 37 i Ligjit për Procedurën Përmbarimore nr.04/L-139, ku Përcakton se, Kur propozimi për përmbarim paraqitet në bazë të dokumentit të besueshëm, mjafton që propozimit t'i bashkëngjitet dokumenti i tillë origjinal apo kopja e tij e vërtetuar sipas ligjit, pra dokumenti në fjalë fatura është dorëzuar në origjinal. Gjithashtu në bazë të dokumentit të besueshëm- Fatura FAT 21051702 e datës 17.05.2021, ku me dispozitën e nenit 29 par. 1 dhe 3 të Ligjit për Procedurën Përmbarimore nr.04/L-139, përcaktohet paragrafi 1 se Përmbarimi me qëllim të realizimit të kërkesës në të holla caktohet në bazë të dokumentit të besueshëm sipas LPP-së. Ndërsa sipas paragrafi 3 përcaktohet se, Dokumenti i besueshëm, është i përshtatshëm për përmbarim po që se në të është treguar kreditori dhe debitori si dhe objekti, lloji, shuma dhe koha e përmbushjes së detyrimit monetar, e në rastin konkret kemi të bëjmë me dokumentin- fatura e cila paraqet dokument të besueshëm, pasi që e njëjta është treguar debitori, përkatësisht i njëjti përmban të gjitha elementet të mjaftueshëm në kuptim të plotësisimit sipas neneve të lartëcekura nga LPP-ja. E po ashtu edhe gjykata e shkallës së dytë, pajtohet në tërësi me qëndrimin juridik të gjykatës se shkallës së parë ky dokument përbën bazë juridike për caktimin e përmbarimit, ngase i ka plotësuar kushtet ligjore nga neni 29 par. 1 dhe 3 dhe 37 të LPP-së, për faktin se ky dokument e ka cilësinë e dokumentit përmbarimor në origjinal dhe është pranuar nga ana e debitorit në mënyrë të rregullt duke e nënshkruar si institucion.

Kjo gjykatë vlerëson se palët ndërgjyqëse mund të iniciojnë procedurë në gjykatën kompetente, për ti provuar pretendimet e tyre rreth mos përmbushjes së detyrimeve që dalin nga raporti detyrimor dhe se fatura në fjalë, në këtë fazë, duke pasur parasysh çështjet kontestuese të lartcekura, si të tilla, janë të përshtatshme për përmbarim, siç me të drejtë konstatoj edhe gjykata e shkallës së parë. Andaj, nga të cekurat kjo gjykatë vlerësoj se aktvendimi i gjykatës së shkallës së parë duhet vërtetuar dhe të refuzohet ankesa e debitorit si e pathemeltë.

Gjykata e shkallës së dytë i shqyrtoi edhe pretendimet tjera ankimore të debitorit, por të njëjtat nuk ndikuan në një vendim ndryshe.

Nga sa u tha me lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi në kuptim të nenit 77 dhe 17 të LPP-së, lidhur me neni 208 dhe 209, pika b), të LPK-së.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS
Dhoma e Shkallës së Dytë
Kom.Dh.shk.II.nr.1510/2023, me datë 05.03.2024

Gjyqtari,
Faton Bajrami, d.v